



# HIDROFIX II

| Konponenti | Ngjyra | Paketimi          | Konsumi                                |
|------------|--------|-------------------|--|
| A          | Gri    | Thes 25 kg, 12 kg | 1.65 (kg/m <sup>2</sup> )/mm trashësia |
| B          | Bardhë | Bidon 8 kg, 4 kg  |  |



## PËRSHKRIM

Material hidroizolues dykomponent me fleksibilitet të lartë me bazë çimento, inertesh të seleksionuar me rërë të imët aditiv specifik dhe polimer fleksibël. Ka punueshmëri të mirë dhe falë rezinave organike përbërëse ka aftësi shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve (gjithmonë të qëndrueshme dhe të pastra), në betone dhe mure, duke krijuar një shtresë fleksibël dhe të papërshkrueshme. Mund të përdoret në ambiente të jashtme dhe të brendshme.

## FUSHA E APLIKIMIT

Veti shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve. Mbrojtje fleksibël dhe hidroizolues për banjo, duše, ballkone, mure dhe tarraca dhe pishina. Hidroizolues përpara vendosjes së pllakave qeramike për suva, dysheme, sipërfaqe betoni, i përshtatshëm për riparime mbi parafabrikatë. Mbrojtës i sipërfaqeve të betonit nën efektin e lagështisë së vazhdueshme, klorureve, sulfateve, etj. I aplikueshëm dhe mbi pllaka dhe mbi bazamente druri.

## PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra, jo të pista dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë. Bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë.

Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhet të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Të vendoset në të gjitha këndet midis mureve dhe dyshemesë, nyjeve teknike dhe atyre të kullimit, shiriti hidroizolues DE-KOBAND prej 10cm.

## MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Hidhni komponentin B të lëngshëm (8 KG) në një enë të pastër dhe duke e përzier hidhni komponentin A të thatë (25kg). Përzieri me një përzierës elektrik derisa të arrihet një masë homogjene, pa kokrriza dhe pa fluska ajri.

## APLIKIMI

Aplikoni produktin në dy shtresa me furçë, rul ose spatul, duke e aplikuar rreth 2 mm për çdo dorë duke vendosur në dorën e parë një rrjetë me fibra qelqi mbi produktin e njomë. Dora e dytë aplikohet pas një periudhe prej 4-6 orë nga njëra-tjetra dhe jo para tharjes së dorës së parë. Produkti përdoret vetëm duke kombinuar komponentin A me komponentin B dhe në sasinë e rekomanduar. Aplikoni produktin në temperatura nga +5°C deri në +35°C.



### TË DHËNAT TEKNIKE

|   | KOMPONENTI A                                | KOMPONENTI B |
|---|---|--------------|
| Pamja:                                      | Pluhur                                      | Lëng         |
| Paketimi:                                   | Thes letre 25/12 kg                         | Bidon 8/4 kg |
| Ngjyra:                                     | Gri   | Bardhë       |
| Konsumi:                                    | 1.65 kg/mm trashësi                         |              |
| Magazinimi:                                 | Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri |              |
| Koha e magazinimit:                         | 12 muaj nga data e prodhimit                |              |
| Masa vëllimore:                             | 1.6-1.7 gr/cm <sup>3</sup>                  |              |
| Granulometria                               | 0.7 mm                                      |              |
| ph i përzierjes:                            | 12  |              |
| Temperatura e aplikimit:                    | +5°C deri në +35°C                          |              |
| Trashësia për shtresë:                      | 1-2 mm (për dorë)                           |              |
| Koha midis duarve:                          | 6-24 orë                                    |              |
| I shkelshëm pas:                            | 24-48 orësh                                 |              |
| Aplikimi i pllakave sipër b ëhet            | Pas 3-5 ditësh                              |              |
| Forca ngjitëse në beton(28 ditë):           | ≥ 0.6 N/mm <sup>2</sup>                     |              |
| Forca ngjitëse pas imersionit në nxehtësi   | ≥ 0.8 N/mm <sup>2</sup>                     |              |
| Forca ngjitëse pas imersionit në ujë bazik: | > 0.5 N/mm <sup>2</sup>                     |              |
| Përshkueshmëria ndaj ujit:                  | I papërshkrueshëm                           |              |
| Reaksioni ndaj zjarrit:                     | Klasa A1                                    |              |